



Pranuar / Dorezuar Prijmjeno / Prodato Received / Delivered	21-04-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKPMShck	2311/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.240/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.240/2022 të datës 16.03.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.240/2022 e datës 16.03.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi Kordinator i Zyres Regjionale në Mitrovicë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 16.03.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1414/2021 të regjistruar me numër A.nr.240/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 01-466/2020 të datës 31.08.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 30.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa Këshilli me datë 07.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 1414/2022 të regjistruar me numër A.nr.240/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 16.03.2022; E-mail nga XH.D. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 16.03.2022; Vendim me numër 01-466/2020 i datës 31.08.2020; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 30.03.2022; Përgjigje në ankesë e datës 07.04.2022; Vendim me numër 01-320/2018 i datës 05.09.2018; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 17.03.2014; E-mail nga M.Zh. për M.Sh. i datës 06.04.2022; E-mail nga M.Sh. për M.Zh. i datës 06.04.2022; E-mail nga M.Zh.



për M.Sh. i datës 06.04.2022; E-mail nga Q.A. për C.Z. i datës 15.04.2022; E-mail nga C.Z. për Q.A. i datës 15.04.2022; Diplomë e M.K. me numër 277 e datës 06.08.2012; Diplomë e G.P. me numër 1970 e datës 22.05.2013; Diplomë e I.T. me numër S-III-116/2007 i datës 18.10.2008; Diplomë e G.P. me numër 1881 e datës 17.10.2018; Diplomë e I.T. me numër 95 i datës 10.12.2002; Diplomë e M.K. me numër 136 i datës 25.10.2007;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi në bazë Vendimit me numër 01-320/2018 të datës 05.09.2018 është konstatuar se ankuesi nga pozita Kordinator i Zyres Regjionale në Prishtinë është transferuar si Kordinator i Zyres Regjionale në Mitrovicë në kuadër të të njëjtës kategori funksionale dhe gradë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon se Vendimi me numër protokolli 01-466/2020 i datës 31.08.2020 është i kundërligjshëm dhe kërkon shfuqizimin e vendimit të anëtarëve si dhe të gjitha vendimet e nxjerrura nga ky komision.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat Publike, konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...", Kolegji vlerëson se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nenparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. rrjedhë se ankesa A.nr.240/2022 e datës 16.03.2022, e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Bazuar në të gjeturat si me lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.240/2022

Çlirim Zeka

Zeka

Procesmbajtës



Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesi,
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

